

Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve

Data: 27.09.2011

V E N D I M

"PËR MIRATIMIN E ZMADHIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRISË "BIRRA
KORÇA" SHPK"

Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë "Birra Korça" SHPK, e thirrur nga Administratori i saj Z. Ropi MITI, zhvilloi mbledhjen e saj sot më datë 27.09.2011, ora 12.00 në adresën: Rruga "Bedri Karapici", ish-Qyteti i Nxënësve, Tiranë, me rendin e ditës si vijon:

- *Miratimi në parim i zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "Birra Korça" SHPK dhe caktimi i ekspertit kontabël i cili do të hartojë raportin përkatës për zmadhimin e kapitalit.*
- *Të ndryshme.*

Ortakët e shoqërisë të pranishëm në mbledhje janë:

- "EGNATIA GROUP" SHA, zotëruese e 86.4% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë, përfaqësuar me vendim të aksionerit të vetëm nga Z. Gezim Zeko
- Z. Franko SARO , zotërues i 9.1% të kuotave të kapitalit të shoqërisë
- Z. Agron MALOLLARI, përfaqësues me prokurë i ortakut Katerina Maiollari zotëruese e 4.6% të kuotave të kapitalit të shoqërisë. , i pranishëm në mbledhje nepermjet video-konferences.

Pasi u morr në shqyrtim çështja e parë e rendit të ditës, u konstatua se kjo çështje e rendit të ditës bën pjesë në kompetencat e Asamblesë së shoqërisë, sikurse është përcaktuar në Statutin e shoqërisë si dhe në nenin 81 e vijues të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe për këtë arsye, në përfundim të diskutimeve, Asambleja e hodhi në votim çështjen e parë të rendit të ditës, dhe në

Mbledhje e Asamblesë së përgjithshme të shoqërisë "BIRRA KORÇA" SHPK

1

Vendim - "Për miratimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "Birra KORÇA" SHPK

përfundim të votimit, pasi u arrit të plotësohet numri i kërkuar i votave, Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë "Birra Korça" SHPK,

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Birra Korça" SHPK me fondet e ofruara nga Ortaku maxhoritar, shoqëria "Egnatia Group" SHA. Vlera që do të investohet për rritjen e kapitalit të shoqërisë është 5 (pese) milion Euro.
2. Të caktojë zj. Ilda EKONOMI në cilësinë e ekspertit kontabël që do të hartojë raportin përkatës në të cilin do të përcaktohet vlera e re e përgjithshme e kapitalit të shoqërisë, nr. total i kuotave, vlera nominative si dhe ndarja e kuotave midis ortakëve.

Pike tjetër e rendit të ditës, për të cilët të gjithë ortakët bihen dakort të diskutojnë:

- Blerja e nje trualli nga Z.Rexhep Haxhi Muslli me sipërfaqe 160 m2 me adrese Mborje Korce. Cmimi per blerjen eshte 5000 lek / m2.

Pasi u mor në shqyrtim kjo çështje, u konstatua se kjo çështje bën pjesë në kompetencat e Asamblesë së shoqërisë, sikurse është përcaktuar në Statutin e shoqërisë si dhe në nenin 81 e vijues të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe për këtë arsye, në përfundim të diskutimeve, Asambleja e hodhi në votim çështjen e parë të rendit të ditës, dhe në përfundim të votimit, pasi u arrit të plotësohet numri i kërkuar i votave, Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë "Birra Korça" SHPK,

VENDOSI:

Dhënie e miratimit për blerjen e truallit të sipërcituar me kushtet e sipërcituara. Autorizohet administratori të nënshkruajë kontratën përkatëse.

ORTAKËT E SHOQËRISË "BIRRA KORÇA" SHPK

Mbledhje e Asamblesë së përgjithshme të shoqërisë "BIRRA KORÇA" SHPK

2

Vendim - "Për miratimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "Birra KORÇA" SHPK

Per ceshjet e pare te rendit te dites: *Zaco Hani Kapitoli*

1. "EGNATIA GROUP" SHA, përfaqësuar nga Z. Gezim Zeko	PRO	<i>Gezim Zeko</i>
2. Franko SARO	kunder	<i>Franko Saro</i>
3. Agron MALOLLARI	kunder	

Per ceshjet e dyte te rendit te dites: *Blago Tralli*

"EGNATIA GROUP" SHA, përfaqësuar nga Z. Gezim Zeko	PRO	<i>Gezim Zeko</i>
Franko SARO	pro	<i>Franko Saro</i>
Agron MALOLLARI	kunder	

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 576/11 REP.
NR. KOL.

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 27.09.2011 (dymijeenjembedhjete), perpara meje noteres
Majlinda E. Demollari, me zyre noterie ne Rr. "Vaso Pasha" u paraqiten personalisht:

Shoqeria "Egnatia Group" SHA perfaqesuar nga Z. Gezim Zeko, Franço Sara dhe
Katerina Malollari e perfaqesuar nga Agron Malollari, shtetas shqiptare, madhor dhe
me zotesi te plote juridike per te vepruar, te njohur personalisht prej meje

Te cilet deklarojne se vendimi i mesiperm eshte hartuar dhe nenshkruar jashte kesaj
zyre dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE
Majlinda E. DEMOLLARI

"BIRRA KORÇA" SHPK

NIPT J64103004E

MBLEDHJA E ASAMBLESE SË ORTAKËVE

DATE: 27.09.2011

ORA: 12.00

PROCESVERBAL

I

MBLEDHJES SË ASAMBLESE

I mbajtur sot në datë 27.09.2011, në orën 12:00 në adresën: Rruga "Bedri Karapici", ish-Qyteti i Nxënësve, Tiranë, ku sipas njoftimit të datës 14.09.2011 të Administratorit të Shoqërisë Z. Ropi MITI, është thirrur Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "Birra Korça" SHPK. Mbledhja filloi në orën 12:00, sipas orarit të caktuar në njoftim. Në mbledhje merr pjesë, ortaku i shoqërisë si vijon:

1. **"EGNATIA GROUP" SHA**, zotëruese e 86.4% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë, përfaqësuar me vendim të aksionarit të vetëm, nga Z. Gezim Zeko
2. **Z. Franko SARO**, zotërues i 9.1% të kuotave të kapitalit të shoqërisë; dhe
3. **Znj. Katerina MALOLLARI**, zotëruese e 4.6% të kuotave të kapitalit të shoqërisë. Merr pjese ne mbledhje nepermjet video konferences perfaqesues i Znj.Katerina Malollari Z.Agron Maiollari.

Rezulton se mbledhja e Asamblesë së Ortakëve është thirrur për të marrë vendime sipas rendit të ditës si vijon:

- **Miratimi në parim i zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "Birra Korça" SHPK dhe caktimi i ekspertit kontabël i cili do të hartojë raportin përkatës për zmadhimin e kapitalit.**
- **Të ndryshme.**

Në bazë të procedurave të parashikuara nga ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe Statutin e shoqërisë, njoftimi për mbledhjen u është dërguar ortakëve në adresat respektive.

Duke qenë se ortakët e pranishëm përfaqësojnë 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, bazuar në ligjin nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe

1

Procesverbal i Asamblesë së përgjithshme të shoqërisë "Birra Korça" SHPK

propozitat përkatëse statutore, Mbledhja e Ortakëve të shoqërisë "BIRRA KORÇA" SHPK,
me qëllim të marrë vendime të vlefshme.

Ortakët pjesëmarrës bien dakord që Z. Gezim Zeko të drejtojë mbledhjen, ndërsa
procesverbalet e mbledhjes do të mbahet nga Artenisa Andoni (identifikuar nga karta e
identifikimit me nr. I85613048R).

Pas kësaj, mbledhja deklarohet e hapur.

Z. Gezim Zeko në cilësinë e drejtuesit të mbledhjes lexon rendin e ditës.

Kalohet në shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës:

- **Miratimi në parim i zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "Birra Korça" SHPK dhe Caktimi i ekspertit kontabël i cili do të hartojë raportin përkatës për zmadhimin e kapitalit.**

Z. Gezim Zeko e merr fjalën i pari:

"Kjo mbledhje është thirrur sot nga Administratori i Shoqërisë "Birra Korça" SHPK dhe pika e parë e rendit të ditës është si më sipër.

Në cilësinë e përfaqësuesit të ortakut maxhoritar, propozoj rritjen e kapitalit të shoqërisë me një vlerë shtesë prej 5 (PESE) MILION EURO . Sa më sipër gjykoj se do të ndikonte në zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit të shoqërisë duke rritur në të njëjtën kohë besueshmërinë e saj në raport me faktorët dhe aktorët e tjerë në treg. Kerkohet që proporcionalisht të kontribuoni dhe ju. Perdorimi i saj do të jete ne perputhje me kerkesat e shoqërisë . Ky është një detyrim ligjor dhe behet per permiresimin e struktures se kapitalit i cili është me minus . Mbi kete baze do te percaktohet dhe nje ekspert qe une propozoj te jete Ilda Ekonomj."

Pas tij, fjalën e mori z. Franko Saro, i cili tha:

"Ku do të shkoje shumica e parave që do të jete per kompanine?"

Pergjigjja nga Z. Gezim Zeko: "Perdorimi i parave do te shkoje ne pakesimin e kredive dhe zvogelimin e kostave financiare"

Pas tij, fjalën e mori z. Agron Malollari, i cili tha:

"Ku kane shkuar dhe kush ka firmosur per marrjen e kredive, ku jane provat?"

Pergjigjja nga Z. Gezim Zeko :-Marrja e kredive është bere me dijenine tuaj, pavaresisht se keni qene kundra, shumica e votave ka qene per pro. Perdorimi i kredive është bere ne konstruksionin e Fabrikes "Birra Korça" dhe permiresimin e cilesise se "Birra Korça".

Keto te dhena jane te pasqyruar dhe ne bilancet respektive.

Z.Agron Malollari dhe Z.Franko Saro thane:- Nuk eshte e vertete qe kredite jane marre ne emrin e Z.Agron Malollari por Z.Franko Saro perjashton nje kredi qe eshte marre ne kohen kur administrator ka qene Z.Eduart Ypi dhe nje tjetere qe ka qene rinovim kredie ne dt:29/06/2011.

Kjo pikë e rendit të ditës hidhet në votim. Ortaku maxhoritar votoi **Pro** miratimit në parim të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë me fondet e shoqërisë "Egnatja Group" SHA në vlerën 5 milion Euro dhe caktimit si eksperte kontabel te Zj. Ilda Ekonorpi. Ortakët e tjerë Z.Franko Saro dhe Z.Agron Malollari votuan **Kunder**. **Kjo çështje e rendit të ditës konsiderohet e miratuar.**

Kjo pikë e rendit të ditës konsiderohet **e mbyllur.**

- Pike tjetere e rendit te dites, per te cilet te gjithe ortakët bihen dakort qe diskutojne.
 - **Blerja e nje trualli nga Z.Rexhep Haxhi Muslli me sipërfaqe 160 m2 me adrese Mhorje Korce. Cmimi per blerjen eshte 5000 lek / m2.**

Fjalën e merr Z.Franko Saro :- Une personalisht jam dakort megjithese kam rezerva se ku mund ti gjeni fondet .

Z.Agron Malollari nuk bie dakort.

Shoqeria "Egnatia Group" Sha bie dakort per miratimin e pikes se mesiperme.

Me shumice votash kjo pike miratohet.

Pasi u vendos per sa me sipër Z.Agron Malollari dh Z.Franko Saro propozojne:

- *Mbledhja here tjetere te kete nje adrese te sakte dhe dokumentat te na dergohen paraprakisht. Kjo te permiresohet ne mbledhjet e tjera te asamblese. Dokumentat qe kerkohen jane vendimet qe kane lidhje me kredite. Keto dokumenta duhet te na vihen ne dispozicion brenda dt:27/10/2011.*

Meqenese nuk ka ndonje kerkesë tjetere per t'u diskutuar apo ndonje shqetesim ose problem ne lidhje me funksionimin e shoqërisë, pasi gjithcka u ezaurua, drejtuesi i mbledhjes e deklaroi atë TË MBYLLUR.

Procesverbali i mbledhjes mbyllet këtu.


Drejtues i mbledhjes

Z. Gezim Zeko



Mbajtës i Procesverbalit

Artenisa Andoni



+ 3

"BIRRA KORÇA" SHPK

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Data: 27.09.2011



Ora: 12.00

LISTA E PJESËMARRËSVE

Në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë


"BIRRA KORÇA" SHPK

ORTAKËT E SHOQËRISË "BIRRA KORÇA" SHPK

Nr.	Ortaku	Prezent/ Jo Prezent	Nënshkrimi i ortakut
1.	"EGNATIA GROUP" SHA, përfaqësuar nga Z. Gezim Zeko	Prezent	
2.	Z. Franko SARO	Prezent	
3.	Zj. Katerina MALOLLARI Përfaqësuar nga Z. Agron Malollari	Prezent nepermjet Video Konferences	

Mbajtësi i procesverbalit:

Artenisa Andoni



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR. 1177 REP.

NR. _____ KOL.

170

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 27.09.2011 (dymijeenjembedhete), perpara meje noteres
Majlinda E. Demollari, me zyre noterie ne Rr. "Vaso Pasha" u paraqiten personalisht:

Z. Gezim Zeko, perfagesues i shoqerise "EGNATIA GROUP" SHA, me cilesine e
ortakut te shoqerise "BIRRA KORCA" SHPK, dhe Artenisa Andoni, shtetas shqiptare,
madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, te njohur personalisht prej
meje

Te cilet deklarojne se procesverbali i muesiperm eshte hartuar dhe nenshkruar jashte
kesaj zyre dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE

Majlinda E. DEMOLLARI

NR. 290 Rep.

V È R T E T I M

(Njësin e njëjtë me origjinalin)

Sot me datë 10.10.2011 para meje Notere Kleva Tabaku ,pranë Zyres sime te Noterisë ndodhur ne Rrugën "Ismail Qemali" Korçë , u paraqiti personalisht :

Orijona Leno banues ne Korçë i cili paraqiti fotokopjen e Veralim date 27.9.2011 I Asamblese se Ortakeve te Birra Korca SHPK

Verifikohet se njësia eshte kopje e njëjtë me dokumentin origjinal,pa shitesa ,korrigjime apo fshirje ,verifikuar prej meje noteres sipas nenit 56 te Ligjit "Për Noterinë " nr. 7829 datë 1.6.1994 dhe pikës 7 të Udhëzimit nr. 6291 date 17.8.2005 te Ministrisë të Drejtësisë.

NOTERE

Kleva Tabaku

PUI LE TARIFE

